2. Bordi i Drejtoreve zgjedh per nje periudhe 4 vjecare si President njerin nga anetaret e tij dhe me propozim te Presidentit nga nje (1) deri me pese (5) zevendes Presidente, numri i te cileve percaktohet gjithnje me ane te nje vendimi te Bordit te Drejtoreve. Bordi i Drejtoreve me propozim te Presidentit mund te pushoje zevendes presidentet perpara mbarimit te afatit te sherbimit te tyre. Cdo anetar i Bordit te Drejtoreve ushtron detyrat e besuara nga Bordi deri ne zgjedhjen e pasuesit te tij apo deri ne zevendesimin e tij me shumicen e votave nga Bordi i Drejtoreve ne raste vdekjeje, doreheqjes apo deshtimi ne perputhje me procedurat e dhena nga ligji apo Statuti present.

Kur mungon Presidenti ose nese ai ka nje pengese per ushtrimin e detyrave te tij ai zevendesohet nga zevendes Presidenti i i caktuar nga Bordi i Drejtoreve dhe nese mungon zevendes Presidenti apo ka nje pengese ne ushtrimin e detyrave, ai zevendesohet nga zevendes presidenti i dyte ne perputhje me rendin e percaktuar nga Bordi i Drejtoreve. Ne qoftese mungojne te dy zevendes presidentet apo neqoftese ata kane nje pengese, atehere ata zevendesohen nga nje Keshilltar i emeruar nga Bordi i Drejtoreve.

Presidenti i Bordit te Drejtoreve apo zevendesi i tij kryeson sesionet e Bordit, duke sugjeruar ceshtjet qe do te diskutohen, drejton sesionet e tij dhe ka te drejten me te larte te mbikqyrjes se funksionimit te Bankes dhe personelit te saj.

Bordi i Drejtoreve mund, me dhe permes vendimit qe pason nje propozim te presidentit te tij, te zgjedhe nje nga anetaret e tij si Drejtor te Pergjithshem te Bankes. Me te njejtin vendim percaktohen gjithashtu edhe kompetencat e tij. Ceshtjet qe kerkojne nje veprimtari kolektive te Bordit te Drejtoreve per rrjedhoje perjashtohen. Presidenti i Bordit te Drejtoreve te Bankes mund te

zgjidhet gjithashtu edhe si Drejtor i Përgjithshëm i Bankes. Me propozim të Presidentit, Bordi i Drejtoreve mund të pushojë drejtorin e përgjithshëm përpara përfundimit të periudhës së tij të shërbimit.

Bordi i Drejtoreve zgjedh gjithashtu si Sekretarin e tij një nga anëtarët e tij apo edhe një person të tretë.

Neni 23

Secili anëtar i Bordit të Drejtoreve përpara fillimit të detyrës dhe brenda (10) ditëve nga zgjedhja e tij duhet të depozitojë në arken e Bankes njëzet aksione të Bankes të cilat janë të patjetersueshme gjatë kohës së detyrës dhe kanë garanci të veçante deri në aprovimin e zgjedhjes së tij nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve

Neni 24

1. Bordi i Drejtoreve mbledhet në sesion të zakonshëm në selinë e Bankes rregullisht një herë në një muaj kalendarik duke ndjekur një ftesë të Presidentit të tij apo të zëvendësit të tij në përputhje me nenin 22 paragrafi 3 të Statutit të present, në një ditë dhe orë të fiksuara nga i njëjti dhe në mënyrë të jashtëzakonshme kur Presidenti e gjykon të përshtatshme apo neqoftesë ajo do të kërkojë nga sepaku gjashtë (6) nga Këshilltarët e tij, por në çdo rast ai duhet të thirrë dhe të mbledhet në sesion në paku një herë në muaj, në përputhje me dispozitat e nenit 20 të ligjit të kodifikuar 2190/1920 dhe të nenit 22 paragrafi 3 i Statutit të present.

2. Në rast se thirrja e Bordit të Drejtoreve është kërkuar nga sepaku gjashtë (6) Drejtore, Presidenti apo zëvendësuesi i tij janë për rrjedhojë të detyruar të:

- a. thërresin Bordin e Drejtoreve duke fiksuar datën e mbledhjes e cila duhet të fiksohet brenda pesëmbëdhjetë (15) deri njëzet (20) ditëve nga paraqitja e aplikacionit relevant.
- b. paraqesin çdo propozim me shkrim në rendin e ditës të mbledhjes së parë të Bordit të Drejtoreve, e cila do të mbahet pas misionit të aplikacionit relevant.

Neni 25

Një kusht i domosdoshëm për vlefshmerinë e vendimit të Bordit të Drejtoreve është ftesa e mëparshme e Presidentit për të gjithë anëtarët e tij apo për sesionet e tij është prezenca personale apo përfaqësimi përmes përfaqësuesit ligjor të gjysmës plus një të Drejtoreve dhe në ndonjë rast të shumicës absolute të anëtarëve të present.

Neni 26

Në rast se në vijim të një dorëheqjeje, vdekjeje apo përjashtimi për çdo arsye një anëtar nuk merr pjesë në Bordin e Drejtoreve dhe se ky anëtar ka qenë zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme,

Drejtoret qe kane mbetur, neqoftese jane present se paku nente (9) mund te zgjedhin perkohesisht nje tjetër për të mbuluar vendin bosh për periudhën e shërbimit që i ka mbetur Drejtorit që është zëvendësuar.

Zgjedhja në fjale i paraqitet për miratim mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme që vjen menjëherë me pas.

Aktet e Drejtoreve që janë zgjedhur në këto mënyra konsiderohen legale edhe në rast se zgjedhja e tyre nuk do të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme. Një përfundim i tillë imponohet kur numri i Keshilltareve është më i vogël se nente (9).

Neni 27

Neqoftese ndonjë Drejtor pa justifikim nuk merr pjesë apo nuk përfaqësohet në një sesion të Bordit të Drejtoreve për një periudhë më të madhe se gjashtë (6) muajsh, konsiderohet se ai ka dhënë dorëheqjen. Përjashtimi nga zyra e tij do të finalizohet që prej ditës së miratimit nga Bordi i Drejtoreve dhe që kur vendimi i tij do të rregjistrohet në Protokoll.

2. Dorëheqja e ndonjë Drejtorit duhet të adresohet Bordit të Drejtoreve dhe do të deklarohet si përfundimtare kur të ketë mbërritur në Bankë pa ndonjë pranim të dorëheqjes.

Neni 28

Cdo anëtar i Bordit të Drejtoreve ka një votë. Neqoftese ndonjë anëtar i Bordit të Drejtoreve mundon apo neqoftese ai ka një pengesë për të qenë present në mbledhje, ai mund të caktojë me shkrim apo me një deklaratë të cilat duhet të rregjistrohet në Protokollin e mbledhjes cdo anëtar tjetër të Bordit të Drejtoreve.

Cdo Drejtor mundet në mënyrë të vlefshme të përfaqësojë vetëm një Drejtor tjetër.

Përfaqësimi në fjale në Bordin e Drejtoreve nuk lejohet të besohet ndonjë personi që nuk është anëtar i këtij Bordi. Askush nga Keshilltaret, Drejtoret apo nepunësit e tjere të Bankës nuk mund të ketë një llogari debitore me kushte të ndryshme përveç kushteve që janë në fuqi për klientet e tjere të zakonshëm të Bankës.

Neni 29

1. Me propozim të Presidentit, Bordi i Drejtoreve është i vetmi organ kompetent për të vendosur për çështje në lidhje me administrimin e Bankës, menaxhimin e pronave të saj dhe arritjen e qëllimeve të Kompanisë në përgjithësi, sic janë të përmendura në cdo detaj në nenin 4 të Statutit present, përveç kompetencave, të cilat mbi dispozitat e shprehura të ligjit apo Statutit i paraqiten për kompetencë Asamblesë së Përgjithshme.

2. Me propozim të Presidentit, Presidenti i Bordit të Drejtoreve vendos për organizimin dhe funksionimin e Bankës në mënyrë të shumtë se një Drejtim të Përgjithshëm, duke emëruar për një periudhë të caktuar dhe duke i pushuar Drejtoret e Përgjithshëm respektive dhe Zv.Drejtoret e Përgjithshëm, të cilët mundet gjithashtu të jenë anëtarë të saj.

3. Bordi i Drejtoreve eshte gjithashtu kompetent:

a. per miratimin e Rregullave te Personelit te Bankes dhe te Rregullores se Brendshme te funksionit te sherbimit te Bankes.

b. te krijojë dege, agjenci dhe Zyra te perfaqesimit ne Greqi dhe jashte saj.

c. te emeroje Drejtoret e Bankes, te marre ne pune personelin, te miratoje pagesat dhe alokacionet e personelit te Bankes dhe ti jape te drejten per te firmosur per veten e vet.

d. te marre pjese ne kapitalin aksioner te Bankave te tjera ne Greqi apo ne ndonje vend tjetër te huaj ose te tjetersoje pjesetaret e saj me vetveten.

e. te miratoje ne cdo kohe cdo shpenzim qe eshte i nevojshem per kontributet e Bankes ne Fondet e Sigurimit te personelit te saj si p.sh. per ato te ndihmes, mireqenies dhe kujdesit.

f. te kontrolloje dhe miratoje deklaraten ekonomike vjetore te Bankes.

g. te propozoje dividendet qe mund ti shperndahen aksionereve dhe te vendose per ato provizoret ne perputhje me dispozitat e nenit 46 te ligjit te kodifikuar 2190/1920.

i. te pergatise raportin per Asamblene e Pergjithshme lidhur me llogarite dhe aktivitetet e Bankes

j. te vendose per propozimet per Asamblene e Pergjithshme dhe te vendose pikat e rendit te dites te saj dhe te vendose per te gjitha pikat ne pergjithesi, te cilat jane te nevojshme per mbrojtjen, administrimin dhe menaxhimin e interesave te Bankes dhe per arritjen e qellimeve te saj.

Bordi i Drejtoreve, me vendimet e veta, mund te transferoje fuqite e tij, totalisht apo pjeserisht, tek Presidenti, Drejtori i Pergjithshem, zevendesit e tyre apo tek anetaret e tjere te tij.

4. Cdo shperblim tjetër qe i jepet ndonje Keshilltari pervec atyre qe percaktohen ne nenin 38 te Statutit prezent mbi perfitimet e Bankes, konsiderohet ligjor dhe rendon Banken vetem neqoftese eshte miratuar me nje vendim special te Asamblese se Pergjithshme te mbledhur ne nje sesion te rregullt.

5. Aktet e Bordit te Drejtoreve madje edhe ne qoftese ato jane jashte qellimeve te Kompanise jane detyruese per Banken karshi personave te trete pervecse neqoftese provohet se personi i trete ka gene ne dijeni te kapercimit te qellimeve te Kompanise apo neqoftese ai duhet ta dinte ate.

6. Anetaret e Bordit te Drejtoreve jane per rrjedhoje pergjegjes karshi Bankes per ndonje akt apo mungese te te njejtij lloj ne administrimin e puneve te Kompanise ne perputhje me dispozitat e neneve 22a dhe 22b te ligjit te kodifikuar 2190/1920, sic eshte ne fuqi sot.

Neni 30

1. Bordi i Drejtoreve perfaqeson Banken perpara Gjykates dhe gjithashtu jashte Gjykates dhe mundet me nje vendim te vetin ti besojë ushtrimin e fuqive dhe kompetencave te veta, si totalisht edhe pjeserisht, te njejteve, madje edhe te drejten e perfaqesimit si edhe zbatimin e vendimit te vet perfshire Presidentin dhe ne vijim te nje propozim te te njetit per Drejtorin e Pergjithshem, per zevendes presidentet, per nje apo me shume anetare te te njetit, per drejtoret e pergjithshem te Bankes apo edhe per nepunes te tjere te saj, duke percaktuar ne te njejten kohe dhe me te njejtin vendim, ceshtjet per te cilat pushtetet e mesiperme i jepen te njetit.

Ceshtjet qe kerkojne nje veprimtari kolektive te Bordit te Drejtoreve per rrjedhoje jane te perjashtuara.

2. Banka eshte e lidhur ne transaksionet e veta ose me nje firme ose me dy (2) firma nga te cilat njera prej tyre eshte domodoshmerisht e para dhe tjetra e dyta. Bordi i Drejtoreve mund ti jape ne menyre te vleftshme nje te drejte te firmes unike vetem Presidentit te vet ose duke vijuar nje propozim te vete atij Drejtorit te Pergjithshem dhe zevendes presidenteve si edhe drejtoreve te pergjithshem dhe zevendes drejtoreve te pergjithshem.

3. Percaktimi i firmes se pare dhe te dyte per anetaret e Bordit e Drejtoreve, Drejtoret e Pergjithshem, zevendes Drejtoret e Pergjithshem, determinohet ne cdo kohe me nje rezolute speciale te Bordit te Drejtoreve duke vijuar nje propozim te Presidentit.

Neni 31

Drejtimi i siperpermendur i veprimtarive te Bankes ushtrohet nga Presidenti i Bordit te Drejtoreve brenda kufijve te autorizimit qe i kane dhene atij.

Bordi i Drejtoreve ne vijim te nje propozimi te Presidentit te vet mund ti besojë drejtimin e puneve, totalisht apo pjeserisht, Presidentit, zevendes presidenteve, drejtoreve te pergjithshem dhe zevendes drejtoreve te pergjithshem.

Presidenti i Bordit te Drejtoreve, Zevendespresidentet, Drejtori i Pergjithshem, Drejtoret Ekzekutive si edhe Zevendesdrejtoret ekzekutive administrojne interesat e Bankes ne perputhje me dispozitat e Statutit present dhe te autorizimit dhene atyre nga Bordi i Drejtoreve.

Secili prej personave te siperpermendur, ne emer te Bordit te Drejtoreve, perfaqeson Banken perpara te treteve dhe perpara Autoriteteve publike dhe Gjykatave dhe per rrjedhoje kane te drejte te bejne apel te rregullt apo te jashtezakonshem, te heqin dore nga apeli ne fjale dhe te emerojne ndonje perfaqesues, te cilit i japin fuqi te veproje. Por per perfaqesimin e Bankes para cdo Gjykate si edhe per cdo Akt juridik, vecanerisht per betim, edhe Drejtoret e degeve te cdo lloji dhe forme te Bankes apo zevendesit e tyre jane per rrjedhoje te autorizuar pervec personave te siperpermendur, duke patur nje autorizim special per rastin konkret i cili eshte paraqitur ne juridiksionin e tyre.

Neni 32

1. Eshte ne menyre strikte e ndaluar per anetaret e Bordit te Drejtoreve, Drejtoret e pergjithshem dhe zevendes drejtoret e pergjithshem si edhe per drejtoret e Bankes te ushtrojne profesionalisht pa nje leje speciale te Asamblese se Pergjithshme per llogari te tyre apo per llogari te te treteve ndonje akt qe eshte tamam me qellimet e Bankes apo te marin pjese si partnere ne ndonje partneritet qe lufton per te njejtat qellime. Ne rast te thyerjes te dispozites se siperpermendur, Banka ka te gjithe te drejtat qe i jane dhene nga neni 23 paragrafet 2 dhe 3 i ligjit te kodifikuar 2190/1920 si eshte ne fuqi.

2. Çdo Drejtor eshte per rrjedhoje i detyruar te ruaje nje sekret absolut mbi punet e Bankes qe ai ka njohur me cilesine e anetarit te Bordit te Drejtoreve.

Kapitulli F

Kontrolli-Bilanci-Dividendet dhe Fondet Rezerve

Neni 33

Per adoptimin ne menyre te vleftshme nga Asambleja e Pergjithshme te nje rezolute relativisht per deklaratat ekonomike vjetore eshte i nevojshem kontrolli i meparshem i te njejtës bere nga Revizoret.

Revizoret ne fjale si dhe ata alternativ, te barabarte ne numer, emerohen gjithnje nga mbledhja e rregullt e meparshme e Asamblese se Pergjithshme dhe ata kompesohen ne perputhje me ligjin.

Emerimi dhe pushimi i tyre per cdo arsye me identifikimin e ceshtjeve te tyre publikohet ne perputhje me dispozitat e dhena nga nenet 7a dhe 7b te ligjit te kodifikuar 2190/1920 si eshte ne fuqi.

Brenda pese (5) ditesh nga mbledhja e Asamblese se Pergjithshme qe i ka emeruar ata, Banka eshte e detyruar ti njoftoje ata per emerimin. Ne rast se Revizoret ne fjale nuk e refuzojne emerimin ne nje limit kohor prej pese (5) ditesh, konsiderohet se ata e kane pranuar ate dhe marrin te gjitha pergjegjesite dhe detyrimet qe rrjedhin nga neni 37 i ligjit te kodifikuar 2190/1920 si eshte ne fuqi tani.

Revizoret e Bankes jane per rrjedhoje te detyruar te ushtrojne misionin e tyre me kujdes dhe jane per rrjedhoje pergjegjes perkundrejt Bankes dhe te treteve per ndonje demtim te provokuar nga aktet dhe mungesat e tyre, dhe ata jane ne menyre te vecante pergjegjes per ndonje demtim te drejtoreve te Bankes relativisht per administrimin dhe menaxhimin, neqoftese ata e dinin ate dhe neqoftese nuk e kane raportuar ne deklaraten e tyre e cila permban rezultatet e kontrollit te ushtruar prej tyre.

Neni 34

Revizoret per ekzekutimin e mandatit te besuar atyre jane per rrjedhoje te fuqizuar te njohin permbajtjen e librave te llogarive, Protokolleve dhe korrespondencen e Bankes por ata nuk mund ti levizin ato jashte Bankes.

Neni 35

1. Revizoret jane per rrjedhoje te detyruar gjate periudhes te ndjekin kontabilitetin dhe situaten administrative te Bankes dhe jane per rrjedhoje te drejte te kene njohuri per cdo liber, llogari apo dokument dhe Protokollet e Asamblese se Pergjithshme dhe te Bordit te Drejtoreve.

Ata procedojne ne ndonje sugjerim te nevojshem per Bordin e Drejtoreve brenda kufinjve te kompetencave te tyre ne perputhje me ligjet dhe ne rast te thyerjes te dispozitave te ligjit apo Statuteve, ata i raportojne Autoriteti mbikqyres kompetent.

2. Pas perfundimit te periudhes, Revizoret jane per rrjedhoje te detyruar te kontrollojne Deklaratat Ekonomike Vjetore dhe ti paraqesin Asamblese se Pergjithshme te rregullt nje raport me konkluzionet e kontrollit te tyre. Nga ai raport, duhet te rezultojne ekspresivisht, pas kontrollit te ekzaktesise dhe legjitimitetit te mbishkrimeve ne Librat e Bankes, neqoftese Deklaratat Ekonomike vjetore perfaqesojne situaten ekonomike te Bankes ne daten e perfundimit te periudhes nen kontroll dhe neqoftese kontabiliteti i rezultateve te periudhes mund te perfaqesojte rezultatet qe vijne nga zgjatja e periudhes.

3. Vecanerisht, deklarata e revizoreve duhet te permende:

- a. neqoftese u eshte dhene ndonje apo i gjithë informacioni qe ishte i nevojshem per zbatimin e punes se tyre.
- b. neqoftese jane informuar per te gjithë deklaraten e veprimtarive te Bankes.
- c. neqoftese eshte prezantuar ndonje modifikim ne metoden e inventarit relativisht ne periudhen e meparshme.

Revizoret duhet te jene prezent ne Asamblene e Pergjithshme dhe te japin cdo informacion lidhur me kontrollin e kryer prej tyre

Revizoret jane per rrjedhoje pergjegjes ne ushtrimin e detyrave te tyre per ndonje gabim, dhe ata jane te detyruar per ndonje shperblim perkundrejt Bankes. Pergjegjesia ne fjale nuk mund te perjashtohet apo modifikohet. Ndonje ankim i Bankes parashkruhet pas dy vjetesh.

Bordi i Drejtoreve duhet te therrase Asamblene e Pergjithshme te Aksionereve pas aplikimit te Revizoreve brenda dhjete (10) diteve nga notifikimi i aplikimit tek Presidenti i tij duke percaktuar objektin e rendit te dites i cili eshte perfshire ne aplikimin ne fjale.

Neni 36

Bordi i Drejtoreve pa kaluar tridhjetë (30) dite nga mbledhja e fundit e rregullt e Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve i dergon Revizoreve inventarin, Bilancin, kontabilitetin e rezultateve te periudhes dhe deklaraten e njejte te Asamblese se Pergjithshme.

Revizoret sepaku brenda njezetepese (25) diteve perpara mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme kthejne mbrapsht dokumentet e siperpermendura sebashku me deklaraten per Asamblene e Pergjithshme, tek Presidenti i Bordit te Drejtoreve

Neni 37

1. Periudha e Kompanise ka nje kohezgjatje prej dymbedhjete (12) muajsh. Ajo fillon me nje (1) Janar dhe mbaron me tridhjeteeenje (31) Dhjetor te te njejtit vit.

2. Ne fund te cdo periudhe te Kompanise, Bordi i Drejtoreve mbyll llogarite, procedon me nje inventar te detajuar te pronave te Kompanise dhe pergatit Bilancin ne perputhje me dispozitat e ligjit dhe e paraqit ate sebashku me deklaraten vjetore per mbylljen e periudhes se Kompanise tek Asambleja e Pergjithshme e mbledhur ne nje mbledhje te rregullt dhe ndonje deklarate spjeguese ne te cilen cdo detaj permendet ne nenin 43b paragrafet 5 dhe 7b te ligjit te kodifikuar 2190/1920 si ishte ne fuqi perpara aplikimit te dekreteve presidenciale 409/86 dhe 498/87 si edhe deklaraten e Revizoreve.

3. Deklaratat Ekonomike Vjetore botohen ne perputhje me ligjin sepaku njezet (20) dite perpara mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme ne perputhje me dispozitat e ligjit.

a. ne nje folio speciale te Gazetes Zyrtare te qeverise mbi Kompanite Aksionere te Inkorporuara dhe Kompanite me Pergjegjesi te Kufizuar

b. ne nje te perditshme politike qe botohet ne Athine, e cila ne perputhje me mendimin e Bordit te Drejtoreve ka qarkullimin me te gjere ne te gjithe vendin dhe e cila eshte zgjedhur nga gazetate e nenit 3 te dekret ligjit 3757/1957 sic eshte tani ne fuqi.

c. ne nje te perditshme ekonomike nga gazetate qe percaktohen nga Ministri i Tregtise

d. ne nje te perditshme politike qe botohet ne vendndodhjen e Bankes neqoftese ajo nuk ndodhet ne distriktin e Bashkise se Athines.

4. Per adoptimin e vlefshem te ndonje rezolute relative mbi deklaratat ekonomike vjetore, pasi jane miratuar nga Bordi i Drejtoreve, deklarata ne fjale duhet te kontrollohet nga Revizoret dhe duhet te vertetohet:

a. nga Presidenti i Bordit te Drejtoreve apo nga Drejtori i Pergjithshem dhe neqoftese nuk ka nje Drejtor te Pergjithshem nga Keshilltari tashme i emeruar nga Bordi i Drejtoreve ne kete pikesynim.

b. nga Drejtori Ekzekutiv kompetent i Bankes apo nga zevendes Drejtori Ekzekutiv kompetent,

c. nga Drejtori i Drejtorisse se Kontabilitetit.

Neqoftese nje person nga te siperpermendurit ka nje mendim te kundert per legjitimitetin e hartimit te Deklaratave Ekonomike Vjetore ai duhet ta referoje ate dhe objeksionet e tij me shkrim ne Asamblene e Pergjithshme

Dhjetë (10) dite përpara një mbledhjeje të rregullt të Asamblesë së Përgjithshme, Deklaratat Ekonomike Vjetore si edhe raportet e Bordit të Drejtoreve dhe të Revizoreve vihen në dispozicion të çdo aksioneri për tu informuar për to, nëqoftesë i kërkon.

Neni 38

1. Fitimet neto të Bankës janë ato që vijnë nga fitimet bruto tashme të realizuara pas zbritjes të gjithë shpenzimeve, dëmeve, shlyerjeve ligjore dhe detyrimeve të tjera të Kompanisë.

2. Fitimet neto për rrjedhojë shpërndahen në bazë të prioritetit që vijon:

a. Një përqindje prej pesë deri në njëzet (5-20%) të fitimeve neto zbritet si një zbritje vjetore për krijimin e fondeve të rregullta rezervë. Mbetja në fjalë nuk është me e detyrueshme kur fondet rezervë të sipërpermendura do të kalojnë gjysmën e kapitalit aksioner. Por nëqoftesë për çdo arsye fondi i rregullt rezervë është bërë me i vogël se gjysma e kapitalit aksioner në fjalë kjo zbritje kthehet perseri në të detyrueshme në atë mënyrë që shuma e sipërpermendur të konvertohet perseri.

b. Një përqindje e barabartë me gjashtë (6%) përqind të kapitalit aksioner tashme të paguar vihet në dispozicion për pagesën e dividendit të parë në përputhje me nenin 44a dhe 45 të ligjit të kodifikuar 2190/1920 në lidhje me nenin 1 të ligjit 876/1979 dhe të nenit 3 të ligjit në fuqi 148/1967 ashtu siç janë në fuqi tani.

c. Mbetja e fitimit disponohet në përputhje me mendimin e Asamblesë së Përgjithshme për krijimin e fondeve rezervë të jashtëzakonshme, për pagesat e Bordit të Drejtoreve dhe çfarë mbetet shpërndahet tek aksionerët si një dividend shtesë apo transferohet për periudhën e ardhshme të Kompanisë.

3. Fitimet neto në përputhje me dispozitat e nenit prezent pas heqjes menjëherë për krijimin e fondeve rezervë të rregullta dhe shpërndarjes së dividendeve të parë mund të vihen pjesërisht apo totalisht në dispozicion për rritjen e kapitalit aksioner duke proceduar me emetimin e aksioneve të reja që i dhurohen aksionereve pa pagesë në vend të dividendit shtesë. Ky distribucion operohet me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me dispozitat e ligjit të kodifikuar 2190/1920.

4. Sipas kushteve për uljen e kapitalit aksioner, nuk mund të bëhet asnjë distribucion tek aksionerët nëqoftesë në datën e përfundimit të vitit të fundit fiskal shuma e fondeve të veta është specifikuar në modelin e Bilancit të dhënë nga neni 42c i ligjit të kodifikuar 2190/1920 siç është tani në fuqi, dhe pas distribucionit në fjalë, është apo do të bëhet me i vogël se shuma e kapitalit aksioner të rritur me fondet rezervë për të cilat distribucioni në fjalë përjashtohet nga ligji apo Statutet. Kjo shume e kapitalit aksioner pakesohet në shumën për të cilën akoma nuk është bërë thirrja për tu paguar. Shumat në fjalë që u shpërndahen aksionereve nuk mund ta kalojnë shumën e rezultateve të periudhës së fundit që tashme ka përfunduar të rritur me fitimet që vijnë nga çdo periudhë paraardhëse dhe me fondet rezervë që mund të shpërndahen dhe për të cilat është lejuar nga Asambleja e Përgjithshme të fillojë shpërndarja me pak se shuma e dëmeve të periudhës së mëparshme dhe se çdo shume që duhet të vihet në dispozicion për krijimin e fondeve rezervë në përputhje me ligjin apo Statutin.

Dividentet ne fjale i paguhen aksionereve me afat dy (2) mujor qe nga vendimi i Asamblese se Pergjithshme te rregullt qe ka miratuar deklaratat ekonomike vjetore sic eshte kushtezuar nga asambleja ne fjale apo nga Bordi i Drejtoreve.

Çdo shume qe i eshte shperndare aksionereve duke dhunuar dispozitat e ligjit te kodifikuar 2190/1920, ashtu sic eshte tani ne fuqi, i kthehet atyre qe e kane mbledhur ate, neqoftese Banka provon se aksioneret ne fjale ishin ne dijeni, apo duhet ta dinin, ne perputhje me rrethanat e vecanta qe distribucionet ne fjale te se njejtës, tashme te realizuara, nuk ishin legale.

Neni 39

Fondi i Rregullt Rezerve krijohet, sic permendet ne nenin 38 te Statutit prezent, kushtezohet ne cdo detaj dhe perdoret ekskluzivisht per balancim, perpara cdo shperndarje te nje dividenti, te debitit ekzistues qe ka mbetur nga perilogaritja e rezultateve dhe fondi i jashtezakonshem rezerve perdoret per te mbuluar demtimet e jashtezakonshme dhe te parashikuara, shlyerjen e debive dhe neqoftese rastet ne fjale nuk ekzistojne ai perdoret per distribucion tek aksioneret te nje dividenti te jashtezakonshem apo per rritjen e kapitalit. Perdorimi i fondit rezerve te zakonshem por madje edhe te jashtezakonshem rregullohet nga Bordi i Drejtoreve dhe ne perputhje me dispozitat e ligjit.

Kapitulli G

Shkrirja dhe likuidimi

Neni 40

1. Banka vazhdon te ekzistojë perderisa Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve me propozim te Bordit te Drejtoreve apo te aksionereve qe perfaqesojne aksione te barabarta me dy te tretat (2/3) e gjithe kapitalit per rrjedhoje vendos zgjidhjen apo shkrirjen e Bankes. Por Banka ne fjale mund te zgjidhet gjithashtu:

a. me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme i cili adoptohet ne perputhje me dispozitat e neneve 16 paragrafet 2-3 dhe 19 paragrafi 2 te Statutit prezent

b. me deklaraten e Bankes ne gjendjen e nje falimentimi

c. me revokimin final nga Autoriteti kompetent i vendit i licences se funksionimit te Bankes.

2. Ne rastin kur totali i fondeve te veta ashtu sic jane percaktuar ne Bilanc nga neni 42c i ligjit te kodifikuar 2190/1920, ashtu sic eshte tani ne fuqi, behet me i vogel se gjysma (1/2) e kapitalit aksioner, Bordi i Drejtoreve eshte per rrjedhoje i detyruar te therrase Asamblene e Pergjithshme brenda nje afati kohor prej gjashte (6) muajsh qe prej perfundimit te periudhes , per te vendosur zgjidhjen e Bankes apo per ta adoptuar ne ndonje forme tjeter.

3. Perqendrimi i teresise se aksioneve te Bankes tek nje aksioner i vetem nuk perben nje aresye per zgjidhjen e Bankes.

Neni 41

Pervec rastit te falimentimit, likujdimi pason zgjidhjen e Bankes. Neqoftese Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve ka vendosur zgjidhjen e Kompanise, ajo percakton gjithashtu edhe menyren e likujdimit, zgjedh tre (3) likujdatore dhe kushtezon kompetencat e tyre. Likujdatori e emeruar nga Asambleja e Pergjithshme, ne menyre simultane me sipermarren e detyrave te tyre, duhet te procedojne me inventarin e pasurise se Bankes dhe hartimin e tij dhe publikimin ne nje folio speciale te Gazetes Zyrtare te Qeverise per Kompanite Aksionere te Inkorporuara dhe Kompanite me Pergjegjesi te Kufizuara, si dhe te shtype gjithashtu edhe Bilancet e likujdimit ne perputhje me rastin 1b te nenit 7a te ligjit te kodifikuar 2190/1920 sic eshte tani ne fuqi, dhe ti paraqese nje kopje te tij Autoritetit Mbikqyres kompetent. Likujdatori jane gjithashtu te obliguar te procedojne ne menyre te njejte per mbarimin e likujdimit.

Neni 42

Emerimi i likujdatoreve ka per pasoje ndalimin e veprimeve te Bordit te Drejtoreve dhe Revizoreve dhe i nenshtrohet publikimit te neneve 7a dhe 7b te ligjit te kodifikuar 2190/1920 ashtu sic eshte tani ne fuqi. Likujdatori, me lejen e Asamblese se Pergjithshme, fuqia e te ciles vazhdon te ekzistojte gjate te gjithë kohezgjatjes se likujdimit, mund ti transferojne te treteve gjate gjithë kohezgjatjes se likujdimit ndonje dhe te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Bankes qe eshte ne proces te zgjidhjes. Gjate likujdimit te Bankes, Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve, ruan te gjithë te drejtat e veta dhe mblidhet ne nje sesion te ftuar nga likujdatori kur ata e gjykojne te nevojshme apo pas nje aplikimi te pakices se aksionereve ne perputhje me nenin 20 te Statutit prezent.

3. E drejta e miratimit te llogarive te likujdimit dhe kryerjes se pagesave te nevojshme i takon Asamblese se Pergjithshme. Per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme zbatohen gjithashtu dispozitat e Statuteve. Aksioneri qe perfaqeson ne vetvete numrin me te madh te aksioneve, i cili emerion gjithashtu nje Sekretar, ose nga aksioneret qe jane prezent apo edhe nje te trete tjetër deri ne zgjedhjen e Presidences perfundimtare, kryeson sesionin e Asamblese se Pergjithshme gjate periudhes se likujdimit. Per sa mbetet, zbatohen gjithashtu te gjitha dispozitat e neneve 10 deri 19 te Statutit prezent.

4. Bilancet e likujdimit miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve e cila vendos gjithashtu per pergjegjesine e likujdatoreve. Rezultatet e likujdimit sebashku me deklaraten qe i referohet arsyeve te cilat mund te pengojne perfundimin e likujdimit i paraqiten Asamblese se Pergjithshme. Mbetja neto e pasurise se Kompanise pas pagimit te ndonje apo te gjithë borxheve, shperndahet tek aksioneret, kesh, ne proporcion me perqindjen e kapitalit qe perfaqeson aksionet e tyre.

5. Likujdatori, gjate likujdimit, ushtrojne te gjithë kompetencat e Bordit te Drejtoreve ne mase te nevojshme apo relative me procedurat dhe qellimet e likujdimit, duke zbatuar gjithashtu rezolutat e Asamblese se Pergjithshme.

Emerimi i likujdatoreve paraqitet ne botim te neneve 7a dhe 7b te ligjit te kodifikuar 2190/1920, ashtu sic eshte tani ne fuqi, dhe ka per pasoje qe ndonje apo te gjithë fuqite e anetareve te Bordit te Drejtoreve ndalojne menjehere se ekzistuari.

Kapitulli H

Dispozita te Pergjithshme

Neni 43

Banka mund te bleje permes Burses aksionet e veta deri ne masen e dhjete (10%) perqindshit te teresise se numrit te tyre, ne perputhje me procedurat e dhena nga ligji.

Neni 44

Statuti prezent eshte reformuar dhe kodifikuar me nje rezolute te Asamblese se Pergjithshme, date 28.12.1994.

Ne lidhje me "modifikimin e nenit prezent te Statuteve", permendur ne nenin 5 paragrafet 1 dhe 2, konsiderohet se i takon modifikimit te ndikuar nga vendimi i siperpermendur i Asamblese se Pergjithshme.

VULA: Autentifikim i neneve te Statutit, Kopje e vertete e neneve te Statutit te SA EMPORIKI TRAPEZA TIS ELLADOS A.E. dhe regj.no.6064/06/B/86/03 siç eshte ne fuqi mbas Mbledhjes se Asamblese se Aksionereve date 28/12/94, aprovuar me Dekretin K2-696/95 te Ministrise se Tregetise dhe regjistruar ne Regjistrin e Kompanive me 3/2/1995.


Athine 22.04.1996

Drejtor (nenshkrimi dhe vula nga Ministria e Tregetise - Anna Metaxa).

Perkthyer nga dokumenti bashkalidhur ne gjuhen greke.

Athine, 17/6/96

T. Roussopoulou (firma)



**Perktheu
EDUARD SULO**

I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

1.1. Banka aksionere "Banka Nderkombetare Tregtare Detit te Zi (Shqiperi) S.A., (ICB)" qe ketej e tutje e quajtur Banke, eshte themeluar mbi bazen e vendimit te Mbledhjes Themeluese te Aksionereve.

Aksioneret e Bankes jane ne listen e Marreveshjes se Themelimit.

1.2. Banka eshte krijuar si nje shoqeri aksionere, njihet si nje entitet ligjor qe ne momentin e rregjistrimit te saj. Banka ka bilancin e saj te pavarur, vulen dhe atributet e tjera te nevojshme.

Banka i bashkengjitet sistemit unik bankar te Shqiperise.

Banka ka te drejte te hape degjet dhe zyrat e saj te perfaqesimit ne te gjithe territorin e Shqiperise dhe i jep atyre te drejta brenda kufijeve te Statutit te Bankes, por pa u dhene atyre te drejta te nje entiteti legal. Banka ka te drejte te hape degjet e saj jashte shtetit me lejen e Bankes Kombetare te Shqiperise si edhe zyrat e saj te perfaqesimit jashte shtetit me njoftimin e Bankes Kombetare te Shqiperise.

1.3. Banka mban pergjegjesi me te gjithe pasurine e saj per te gjitha detyrimet e saj perfshire depozitat private. Aksioneret e Bankes mbajne pergjegjesi per detyrimet e saj vetem ne kufijte e vlerave te aksioneve qe u takojne. Banka nuk mban pergjegjesi per detyrimet e aksionereve.

1.4. Ne te gjithe veprimtarine e saj Banka drejtohet nga ligjet e aplikueshme Shqiptare dhe aktet normative e direktivat e Bankes Kombetare Shqiptare qe rregullojne veprimtarine bankare, si edhe nga ky statut.

1.5. Banka, per te drejtuar aktivitetin e saj dhe per te mbrojtur interesat e saj, ka te drejte te krijojte ose / dhe te bashkohet me njesite bankare, shoqatat dhe kompanite e llojeve te tjera. Banka eshte e pavarur nga organizmat qendrore dhe ekzekutive dhe vendimet e lidhura me aktivitetin e saj i merr ne perputhje me ligjet shqiptare, rregullat e Bankes Kombetare Shqiptare si dhe me rregulloret aktuale.

1.6. Qendra si edhe adresa legale e Bankes jane ne Tirane, Shqiperi.

1.7. Kohezgjatja e Bankes do te jete 99 (nentedhjetete e nente) vjet dhe fillon nga dita e krijimit dhe e miratimit te statutit te saj. Kohezgjatja mund te ndryshoje me vendim te Mbledhjes se Pergjithshme te Aksionereve.

II. FONDET, AKSIONET DHE LETRAT ME VLERE TE VETE BANKES

2.1. Fondet e vete bankes konsistojne ne kapitalin themeltar, fondin rezerve, fondin e riskut dhe cdo fond tjeter i krijuar qe ne perputhje me rregulloret aktuale vjen nga fitimi. Formimi dhe perdorimi i ketyre fondeve duhet te miratohet nga Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve.

2.2. Kapitali themelues i bankes eshte percaktuar ne shumen prej 3 000 000 (tremilione) USD dhe i ndare ne 3 000 (tremije) aksione te thjeshta te rregjistruara me vlere nominale prej 1 000 (njemije) USD. Ky kapital themelues do te krijohet ne ditën e rregjistrimit te bankes, ai do te jete perhere ne valute te huaj, perderisa nuk do te kerkohet ndryshe nga autoritetet shqiptare. Ne rast te nje rritjeje ne te ardhmen kapitali themelues shtese i bankes mund te emertohet ne USD ose ne Leke.

2.3. Aksionet e lartpermendura shperndahen mes Aksionereve Themelues te Bankes ne perputhje me Marreveshjen e Themelimit.

2.4. Aksionet paguhen nga Aksionistet ne valute te forte te konvertueshme.

2.5. Banka ka te drejte te marre vendim mbi ndryshimin e Kapitalit Themelues sic eshte percaktuar ne kapitullin 9, me poshte.

2.6. Personi qe perfiton aksionin, kerkon te drejtat e Aksionerit te Bankes pas rregjistrimit te perfitimit te aksionit ne rregjistrin e aksionereve. Llojet e aksioneve qe mund te nxjerre banka ne lidhje me rritjen e kapitalit themelues percaktohen nga Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve ne perputhje me rregulloret presente.

2.7. Per terheqjen e fondeve ekstra, banka ka te drejte te nxjerre obligacione dhe lloje te tjera letrash me vlere ne perputhje me ligjet presente.

2.8. Banka krijon fondin rezerve dhe fondin e riskut si edhe cdo fond tjeter per te perballuar detyrimet e bankes dhe per te mbuluar humbjet e mundshme gjate veprimeve te saj.

III. VEPRIMTARITE DHE OPERACIONET E PERGJITHSHME TE BANKES

Objektet dhe operacionet per te cilat u krijua banka jane:

3.1. Te ekzekutoje ne emer te vete bankes, dhe / ose ne emer te klienteve, cdo lloj operacioni te lejuar nga Ligji Bankar Shqiptar dhe gjithashtu nga cdo lloj tjeter veprimtarish ne perputhje me rregulloret presente.

3.2. Te hape llogarine korresponduese (ne Qendren rregullatore te Bankes Kombetare te Shqiperise) per ekzekutimin e operacioneve dhe mbajtjen e fondeve monetare. Sipas llojeve te operacioneve te ekzekutuara banka konsiderohet si universale.

3.3. Llojet kryesore te operacioneve jane si me poshte vijon:

1. te marre dhe shperndaje depozitat monetare;
2. te terheqe dhe jape kredi;
3. te ekzekutoje pagesa ne baze te udhezimeve te klienteve dhe bankave korrespondente;
4. te bleje dhe shese kambiale;
5. te mbaje llogari te klienteve dhe bankave korrespondente;
6. te jape para ne dore (cash) dhe lloje te tjera sherbimesh me para dhe letra me vlere per klientet;
7. te financoje depozitat e kapitalit ne baze te udhezimeve te pronareve te fondeve te investimit;
8. te bleje, shese, emetoje, skontoje, te hartoje, te beje, te pranoje, te jape, qarkulloje, te njohe, te ofroje, te nenshkruaj, te garantoje nenshkrimin, te ekzekutoje, te negocioje te garantoje, te mbaje, te transferoje, te investoje dhe te punoje ne, te paguaje, shperbleje, te terheqe, te siguroje ose perndryshe te mbylle obligacione, te jape letra angazhimi (premtimi), letra kembimi, fatura, letra me vlere ose instrumenta te transferueshme ose te negociueshme;
9. te jape sigurime, garanci dhe lloje te tjera detyrimesh ne favor te paleve te treta;
10. te perfitoje te drejten e kerkimit te lirimit te mallrave, te grumbulloje sherbime, te riskoje ne plotesimin e kerkesave te tilla dhe te mbledhe kerkesa te tilla (si agjent);



- 11.te bleje valute cash dhe valuten e vendosur ne llogarite dhe depozitat e organizatave e personave private;
- 12.te bleje dhe te shese metale te cmuara, metale te cmuara ne gjendje natyrore, gure te cmuar natyrore dhe gure te cmuar te perpunuar.
- 13.te terheqe dhe te depozitoje metale te cmuar ne llogarite dhe depozitat dhe cdo lloj tjetër transaksioni ne perputhje me praktikat kombetare bankare;
- 14.te ofroje operacione konfidenciale:te terheqe dhe shperndaje fonde, te menazhoje letrat me vlere ne baze te udhezimeve te klienteve;
- 15.te nxjerre dhe transaksionojte te gjitha llojet e biznesit ne lidhje me kartat e kreditit dhe debitit bankar dhe cdo lloj tjetër kartash te nxjerra nga banka ose kompani ose person tjetër dhe pergjithesisht te transaksionojte biznesin ne lidhje me te gjitha llojet e sistemeve te pageses bankare;
- 16.te veproje si konsulent dhe keshilltar ne lidhje me menazhimin e pasurise dhe sigurimin e cdo lloji dhe aspektet e tatimeve, dhe ceshtjeve te pensionit, dhe menazhimin,dhe investimin e parave dhe pergjithesisht te transaksionojte cdo lloj te biznesit konsultativ e keshillues;
- 17.te menazhoje e ndermarre operacione shkembimesh ne baze te kurseve valutore te percaktuara nga kerkesa dhe oferta, te organizojte departamente cash per shkembimin e valutes;
- 18.te perfundoje marreveshje lidhur me aktivite financiare dhe bankare, perfshire marreveshjet qe vendosin mardhenie korespondente me institucionet e Republikes se Shqiperise dhe gjithashtu me kompanite e huaja dhe nderkombetare;
- 19.te nxjerre botimet e veta, te bashkohet me kompanite dhe organizmat kombetare e nderkombetare qe merren me veprime financiare ekonomike, valutore e bankare;
- 20.te menazhoje lloje te tjera operacionesh ne perputhje me rregulloret presente.

Operacione te tilla do te kryhen ne monedhen kombetare dhe valute te huaj.

3.4 Sipas Udhezimeve te Qeverise ose organizmave te tjera shteterore te cilave shteti ju ka dhene fuqi :

1. te veproje si nje agjent ne cdo lloj operacioni lidhur me Banken mbi bazen e marreveshjeve te perfunduara;
2. te veproje si agjent i tyre ne lidhje me kredite shteterore te kerkuara ose te dhena nga shtete te tjera ose kompani te huaja.

3.5 Te financoje ose te veproje per llogari te klienteve me import, eksport, klering, leasing, marrjen me qera, lenie e dhenie me qera, shkembimin, lenien peng apo dhenien e paradhenieve mbi kete peng ose veprime ne lidhje me transaksionet e klienteve si agjente tregtare per llogari te nje tjetri, si tregtar ose me ndonje kapacitet tjetër ne lidhje me pronen e palujtshme personale, sic eshte theksuar edhe me lart.

3.6 Te veproje si agjent regjistrues dhe transferues per klientet, te mbaje per ta cdo regjister ne lidhje me cdo leter me vlere, te mbaje dokumenta dhe llogari te tjera per klientet dhe te ndermarre detyra te tjera per cdo kompani, sherbim ose person qofte lidhur me regjistrimin, transferimin ose me emetimin dhe depozitimin e certifikatave ose dokumentave te tjere te ketij lloji ose titujve evidencues ose te ndonje ceshtje tjetër te cfaredoshme.

3.7 Te veproje si tutor per zoteruesit e letrave me vlere te cdo kompanie ose personi dhe te veproje si menazhere dhe tutore e njesive te trustit, trustit te investimeve dhe pensioneve, fondeve te bamiresise ose fondeve te tjera dhe te transaksionje gjithë llojet e biznesit qe lindin nga ose ne lidhje me ndonje nga zyrat ose trustet e lartpermendura.

3.8 Persa i perket tregut te kapitalit financiar ose operacioneve te depozitimeve private, te promovojë, negocioje, veproje, ofroje per shitje me tender ose ndryshe, nenshkruaje, garantoje, siguroje depozitimet ose te nenshkruaje, ofroje ose prokuroje nenshkrimin (ose me kushte ose absolut), te marre pjese, kryeje, menazhoje, (me komision ose me cmim) ose te kryeje ndonje funksion tjetër ne lidhje me cdo ceshtje (publike ose private) te letrave me vlere te ndonje kompanie apo personi dhe te huaje para me qellim te ceshtjeve te tilla.

3.9 Te garantoje, jape sigurime per mbeshtetje dhe te behet pergjegjes ose i ndergjegjshem ose persa i perket vlefshmerise, besueshmerise dhe autenticitetit te te gjitha llojeve te titujve, letrave me vlere, instrumentave, kontratave, akteve dhe dokumentave dhe pageses se kapitalit, principalit, shperblimeve, dividenteve, interesit dhe parave te tjera dhe kryerja e cdo detyrimi te siguruar ose te pagueshem ose te kryeshem me ane ose ne lidhje me letrat me vlere, te ndermarre sigurime, kundërsigurime dhe risigurime te te gjitha llojeve te garancive, kundërgarancive, demshperblimeve dhe kundërsperblimeve.

3.10 Te krijojë dhe emetoje cdo leter me vlere per cdo lloj qellimi perfshire (por pa kufizim) me ane te sigurimit ose demshperblimit ose ne lidhje me ose

ne ane te permbushjes se detyrimeve te cdo pergjegjesie te bankes ose te ndonje kompanie ose personi tjeter.

3.11 Te siguroje dhe shlyeje cdo borxh a detyrim te ose qe e lidh banken ne ate menyre qe mund te mendohet e pershtatshme dhe vecanerisht me ane te pengjeve dhe detyrimeve mbi te gjitha ose nje pjese te sipermarrrjes, pasurise dhe te ardhurave (te tashme dhe te ardhme) dhe kapitalit te paguar te bankes.

3.12 Te koordinoje, financoje, mbeshtese, subvencionoje, dhe menazhoje te gjitha ose ndonje pjese te biznesit dhe operacioneve te ndonjeres ose gjitha kompanive ne te cilat banka interesohet ose si aksionere ose te nje forme tjeter dhe direkt ose indirekt dhe pergjithesisht te vazhdoje biznesin e nje kompanie holding ne te gjitha aspektet e saj.

3.13 Te financoje projektet e investimit, per ndertim, konstruksion, pajisje, kryerjen, permiresimin, punimin, zhvillimin, administrimin, mbajtjen, menazhimin ose kontrollin e puneve, uzinat, fabrikat, skelat, molot, rruget, hekurudhat, depot e mallrave, magazina, zyra, dyqane, miniera, kanale, rezervuare, marinat dhe godina, struktura ose lehtesira te tjera te te gjitha llojeve.

3.14 Te vazhdoje bizneset e dhenies se sherbimeve mbikqyrese ose keshilluese te sekretarise, menazheriale, konsultuese, kontabiliste, statistikore, ligjore dhe ndonje mbikqyrje ose keshillim sherbimi te cfaredolloji per ose ne lidhje me cfardo kompanie personi, pasurie ose biznesi.

3.15 Te ofroje propozime biznesi duke kerkuar dhe perdoruar dhe duke zhvilluar cdo rast per punesimin e kapitalit dhe nese shihet e pershtatshme duke angazhuar e punesuar specialiste te investigoje, eksploroje dhe ekzaminoje specifikisht ose pergjithesisht perspektiva, situata, kushte dhe rrethana te cdo veprimtarie sipermarrrje dhe koncerni dhe ndonje koncesioni, te drejtash, pasurise ose te ardhurash te cfaredo lloj natyre.

3.16 Te hyje ne cdo marreveshje bankare dhe financiare nese kerkohet me cdo qeveri ose autoritete nderkombetare, supreme, bashkiake, lokale etj dhe te perfitoje te drejta, privilegje ose koncesione prej cdo qeverie ose autoriteti te tille, te cilat banka mund ti mendoje te deshirueshme per te perfituar duke vazhduar ushtimin dhe plotesuar rregullimet, te drejtat, privilegjet dhe koncesione te tilla.

3.17 Te marre ose te bjere dakort te ndermarre hapa dhe procedime te tilla perfshire (por pa kufizim) sipermarrjen e ndonje detyrimi monetar apo ndonje lloji tjeter kur mund te shihen te kalkuluara mire per mbajtjen lart dhe mbeshtetur kreditin e bankes dhe per te perfituar ruajtjen, restaurimin ose justifikimin publik te konfidences ne banke ose te largoje ose minimizojte shqetesimet financiare qe mund te demtojne banken.

3.18 Te nenshkruaj aksione, dhuroje ose garantoje para per cdo objekt kombetar apo nderkombetar, bamiresie, ose objekte te tjera qe mund te konsiderohet sikur direkt ose indirekt con perpara interesat e bankes ose te aksionereve te saj.

3.19 Te krijoje dhe mbaje ose kontribuojte ose ndryshe te subvencionoje ose mbeshtese ndonje fond pensionesh pleqerie per perfitim dhe te jape ose prokuroje dhenien e donacioneve, ndihmes ne para, pensioneve, pagesave ose rrogave per ndonje individ qe eshte ose ishte ne ndonje kohe drejtor, zyrtar, nepunes, puntor ose agjent i bankes apo ndonje kompanie e cila eshte ose ishte ne ndonje kohe kompani aksionere (holding) ose e cila eshte ose ishte ne ndonje kohe ose ndonje menyre nendege e bankes ose me ndonje kompani te tille e cila ishte ose eshte aleate ose e asociacuar me banken apo ndonje kompani holding apo nendege ne te cilen banka apo kjo kompani eshte aleate apo e asociacuar apo eshte ose ishte ne nje kohe e interesuar si aksioner apo ndryshe dhe nese direkt apo indirekt ose ndonje paraardhes i biznesit ne banke apo ndonje kompani tjeter e tille, dhe grate, te vejat, familjet, vartesit, dhe perfaqesuesit personale te individeve te tille sic thame me siper dhe te vendose dhe te mbaje apo te kontribuojte apo perndryshe te mbeshtese cdo institucion, asosacion, klub, trust apo fonde, te cilet mund te konsiderohen se mund te perfitojne si personat e siperpermendur apo ne interes te bankes apo te ndonje paraardhesi ne biznes.

3.20 Te bleje ose mbaje sigurime per ose ne interes te ndonje personi qe eshte ose ishte ne ndonje kohe drejtor, zyrtar, nepunes, ose revizor i bankes ose i ndonje kompanie tjeter qe eshte kompani aksionere e saj ose ndonje nga pararendesit e bankes ose e ndonje kompanie te tille qe ka interes qofte direkt ose indirekt, e cila ne nje fare menyre eshte aleat ose i asociuar me banken ose ndonje nga nendegjet, sipermarrjet e saj ose ne te cilen banka ose ndonje kompani tjeter e tille posedon ndonje ineteres ose e cila eshte ose ishte ne nje kohe tutor i ndonje fondi pensionesh ne te cilin punonjesit e bankes ose te ndonje kompanie te tille ose nendege, sipermarrje ose organi jane te interesuar, perfshire (pa asnje paragjykim per gjeneralitetet e paraprijesit) sigurimin perkundrejt ndonje pergjegjesie te pesuar nga persona te tille lidhur me ndonje

akt ose pakujdesi ne ekzekutimin aktual ose te nenkuptuar dhe ose shkarkim nga detyra dhe ose ushtrimi i fuqive te tyre etj ne lidhje ose ne mardhenie me detyrat, fuqite ose funksionet e tyre ne lidhje me banken ose ndonje kompani, nendege, sipermarrje, organ ose fond pensionesh tjeter te tille.

3.21 te akumulroje ndonje fond monetar te lire te ndermarrjeve dhe institucioneve dhe ti mbaje ato me pagese, shlyerje, depozitim dhe ndonje lloj tjeter llogarie. Te terheqe fonde monetare te personave private neper depozita. Te pranoje fonde monetare per nje periudhe te caktuar kohe.

Te marre masat per sigurimin e fondeve monetare te sipermarra. Pagesat per ndermarrjet, institucionet dhe personat private do te behen ne perputhje me kushtet e marreveshjeve koresponduese.

3.22 te jape kredi per ndermarrjet, shoqatat, institucionet, agjencite dhe personat private duke i njohur kredite si urgjente, te kthyeshme dhe te pagueshme. Kredite e dhena duke u mbeshtetur ne vleresimin nga drejtimi i bankes mund te mbulohen nga lenia peng e pasurise se huamarresit, e cila mund te kerkohet ne perputhje me rregulloret aktuale, me garancite, autorizimet dhe detyrimet ne forma te tjera.

Te percaktoje mjaftueshmerine e te gjitha garancive, autorizimeve dhe detyrimeve.

Te ruaje sekretin e operacioneve, llogarive dhe depozitave te klienteve dhe korespondenteve, perjashtuar sic parashikohet nga ligji. Gjithe stafi i bankes eshte i detyruar te ruaje fshehtesine e informacionit mbi operacionet, llogarite dhe depozitat e bankes, klienteve te saj dhe korespondenteve.

3.23 Te menazhoje operacionet ne valute te huaj ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj ne baze te licences se Bankes Kombetare te Shqiperise dhe ne perputhje me rregullat e fiksuara nga Banka Kombetare e Shqiperise.

3.24 Te marre pjese me kapitalin e saj ne ndermarrje dhe institucionet industriale, komerciale, sherbimit ose financiare.

Te perfaqesoje interesat e ndermarrjeve dhe institucioneve ne organet financiare dhe operacionale sipas udhezimeve te tyre.

3.25 Te realizoje cdo lloj aktiviteti bankar te cfaredo lloj natyre te cilin Bordi i Drejtoreve te Bankes mund te gjykoje me fitim ne lidhje ose si shtojce e aktiviteteve te tjera bankare, te permendura ne rregulloret presente ose mund te gjykohen te dobishme per rritjen e te ardhurave ose ne menyre direkte ose

indirekte te vleres se ndonje pasurie ose te ardhurash ose per permbushjen e detyrimeve te bankes ose per perdorimin e ndonje instruksioni ose ekzaminim ekspert.

3.26 Te lidhe mardhenie me klientet dhe cdo lloj korrespondenti.

3.27 T' i jepet e drejta te :

- marre nga ndermarrjet e organizatat te cilave u eshte dhene kredi raportet, bilancet dhe dokumentat qe vertetojne aftesine e tyre paguese dhe provizionin e kredive te dhena ;
- kerkoje ekzaminim ekspertesh per rezolutat e projektit lidhur me ndertimin, zgjerimin, rikonstrukcionin dhe ripajisjen teknike te objekteve te cilat jane supozuar te realizohen me pjesmarrjen e fondeve ose kredive te vete bankes ;
- pushoje kreditimin e metejshem, te kerkoje shumat e kredive te dhena nese ndodh ndonje dhunim i detyrimeve lidhur me marreveshjet e kreditimit ne rastet e raportimit perkates ose kontabilizimi te crregullt ose ne ndonje rast te keqesimit te gjendjes financiare te huamarresit ose perspektivat financiare te ndermarrjeve ose organizatave te kredituara ;
- deklarroje ndermarrjet ose institucionet e paafta te paguajne sipas ligjit. Te jape propozime per riorganizimin e tyre;
- percaktoje normen ne perqindje per ekzekutimin e operacioneve aktive ose pasive mbi bazen e marreveshjeve me klientet dhe gjithashtu per sasine e pageses se pensionit per sherbimet ne pune.


IV. DISPOZITAT E INTERESAVE TE KLIENTEVE

4.1 Banka eshte perhere e gatshme te plotesoje ne menyren e duhur dhe ne kohe detyrimet me anen e rregullimit te struktures se bilancit te vet dhe depozitimit te soliditetit financiar te bankes ne perputhje me normat e Bankes Kombetare te Shqiperise. Banka depoziton nje pjese te fondeve te saj te terhequra, ne Banken Kombetare te Shqiperise ne fondin e rregullimit te burimeve te kreditit te sistemit bankar ne perputhje me normativat e aplikuar.

V. BURIMET E KREDITIT TE BANKES

5.1 Burimet e kreditit te bankes formohen nga :

- fondet e veta (minus vleren e fondeve te pergjithshme te kerkuara, kontributet



ne aksionet dhe fondet e bankave, ndermarrjeve dhe organizatave te tjera, fondet e imobilizuara) ;

- fondet e kompanive, individeve dhe organizatave te futura ne llogarine e bankes, perfshi fondet e terhequra ne formen e depozitimeve kohore ;

- kredite e bankave te tjera ;

- fonde te tjera te terhequra.

Burimet e kreditit mundet gjithashtu te perfshijne fitimin e pashperndare gjate vitit operacional te bankes.

VI. SHPERNDARJA E FITIMIT TE BANKES

6.1 Pas pagimit te te gjitha taksave dhe alokacioneve te fondeve fitimi, ne perputhje me rregulloret presente, perdoret ne menyren e percaktuar nga Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve te Bankes.

VII. STRUKTURA E DREJTIMIT TE BANKES

7.1 Organi suprem i drejtimit te Bankes eshte Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve.

Drejtimi i veprimtarive korrente te Bankes realizohet nga organi i saj ekzekutiv - Bordi i Drejtoreve, i zgjedhur nga Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve.

VIII. AKSIONERET DHE TE DREJTAT E TYRE

8.1 Aksioneret i ushtrojne te drejtat e tyre ndaj administrimit te bankes vetem ne Mbledhjen e Pergjithshme te Aksionereve.

Cdo aksioner i jep te drejte mbajtesit te marre pjese personalisht ose me perfaqesues te autorizuar me nje vote ne Mbledhjen e Pergjithshme te Aksionereve. Nje perfaqesues mund te jete ose jo nje aksioner.

Nese nje aksioner mbahet nga me shume se nje aksioner, atehere te gjitha bashkepronaret jane te detyruar ti komunikojne me shkrim Bankes per perfaqesuesin e tyre te perbashket per kete aksioner. Deri ne emerimin e ketij perfaqesuesi, ushtrimi i te drejtave per kete aksioner pezullohet.

8.2 Pergjegjësia e secilit aksioner kufizohet ne vleren nominale te aksionit te tij.

8.3 Zoterimi i nje aksioni dhe kapaciteti i aksionerit ka per pasoje pranimin pa kushte te ketyre rregulloreve, ndonje prej amendamenteve te tyre dhe vendimeve te Bordit te Drejtoreve dhe Mbledhjes se Pergjithshme te Aksionereve te Bankes ne perputhje me ligjin.

8.4 Ne rast te rritjes se kapitalit themelues me emetimin e obligacioneve te konvertueshme ne aksione, ka nje preference ne favor te aksionereve qe kane qene aksionere ne kohen e emetimit te aksioneve dhe obligacioneve te reja te bankes, per te gjithë pjesen e re te kapitalit dhe huave ne formen e obligacioneve.

Pas kalimit te afatit te kohes per ushtrimin e te drejtes se preferences, e cila ne cdo kohe percaktohet nga Bordi i Drejtoreve te Bankes, Bordi mund t'i vere aksionet e pakerkuara nga aksioneret e pare ne dispozicion si te deshiroje. Ne njoftimin lidhur me ekzekutimin e te drejtave te preferences duhet te perfshihet e shenuar data e fundit e ekzekutimit te ekzekutimit te tille.

8.5 Aksioneret qe perfaqesojne nje te dhjeten (1 / 10) e kapitalit aksioner te paguar mund te kerkojne thirrjen e nje Mbledhje te Pergjithshme te jashtezakonshme nga Bordi i Drejtoreve. Ne kete rast Bordi i Drejtoreve eshte i detyruar me paraqitjen e fatures se depozitimit te aksioneve dhe te autorizimeve respektive te therrase nje Mbledhje te Pergjithshme te Aksionereve brenda 30 diteve nga komunikimi i kerkeses. Paraqitja e fatures se depozites se aksioneve dhe te autorizimeve perben nje bilete hyrje per ne Mbledhjen e Pergjithshme te Aksionereve. Kerkesa duhet te tregojë rendin e dites te Mbledhjes se Pergjithshme te Aksionereve.

IX. MBLEDHJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE

9.1 Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve eshte organi suprem i Bankes dhe ka force te vendose per cdo pune te Bankes. Ajo ligjerisht merr vendime duke i bere te detyrueshme per aksioneret qe nuk jane prezent ose qe nuk bien dakort me rezolutat e votuara nga shumica.

9.2 Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve eshte ekskluzivisht kompetente per te marre vendime per :

- Shtyrjen e kohezgjatjes se bankes, shkrirjen, ndryshimin e rezidences ose shperberjen e Bankes ;



- amendamente te rregulloreve ;
- rritjen ose zvogelimin e Kapitelit Themeltar ;
- emetimin e obligacioneve sic percaktohet nga legjislacioni korrent ;
- emerimin e antareve te Bordit te Drejtoreve e miratimin e shperblimit te tyre
- emerimin e revizoreve dhe komitetit revizionues e miraton shperblimin e tyre
- aprovimin e deklaratave financiare vjetore ;
- shkarkimin e anetareve te Bordit Drejtoreve dhe revizoreve nga ndonje pergjegjesi per demshperblim bankes per nje vit te administrimit te tyre.

9.3 Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve thirret nga Bordi i Drejtoreve rregullisht ne rezidencen e Bankes, cdo vit brenda 90 diteve nga fundi i periudhes fiskale te meparshme. Bordi i Drejtoreve ka te drejte te therrase Mbledhjen e Pergjithshme te jashtezakonshme te Aksionereve kurdo qe Drejtoret e konsiderojne te dobishme.

9.4 Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve duhet te njoftohet 15 dite para dates se fiksuar per mbledhjen. Data e njoftimit te thirrjes se Mbledhjes se Pergjithshme dhe data e Mbledhjes se Pergjithshme nuk llogariten.

9.5 Aksioneret njoftohen per thirrjen e Mbledhjes se Pergjithshme te Aksionereve me ane te njoftimit te pergjithshem te botuar ne qytetin ku eshte vendosur qendra e Bankes. Njoftimi mundet gjithashtu te perfshije daten (datat) kur do te mbahen mbledhja (mbledhjet) e perseritura ne rast se mbledhja e pare nuk zhvillohet. Ne kete rast, datat e mbledhjeve mund te jene 10 dite kalendarike larg njera tjetres.

9.6 Njoftimi per Aksioneret i Mbledhjes se Pergjithshme duhet te tregojte me qartesi ditene, kohen dhe vendin e Mbledhjes se Pergjithshme si dhe rendin e dites. Ky njoftim varet ne nje vend te dukshem ne qendren e Bankes.

9.7 Perpara Mbledhjes se Pergjithshme te Aksionereve, Bordi i Drejtoreve me kerkesen e nje aksioneri, ve ne dispozicion raportin financiar vjetor dhe kopje te raportit te Bordit te Drejtoreve dhe revizoreve.

9.8 Aksioneret qe deshirojne te marrin pjese ne Mbledhjen e Pergjithshme te Aksionereve duhet te depozitojne aksionet e tyre pese dite perpara dites se mbledhjes ne qendren e Bankes.

9.10 Aksioneret qe kane te drejte te marrin pjese ne Mbledhjen e Pergjithshme mund te perfaqesohen ne te nga persona qe jane te autorizuar ligjerisht.

Entitetet ligjore, minorenët, personat e ndaluar dhe ata që pergjithesisht nuk mund të jenë me ligj prezent perfaqesohen vetem nga perfaqesues ligjore.



1 Vertetimet e depozitimit të aksioneve dhe dokumentat e autorizimit duhet të depozitohen në Banke pesë (5) dite para ditës që është fiksuar për Mbledhjen e Pergjithshme të Aksionereve.

9.12 Aksionerët që nuk kanë ndjekur rregullat e paragrafeve 9 dhe 11 të këtij neni nuk mund të marrin pjesë në Mbledhjen e Pergjithshme të Aksionereve përveçse nëse kjo është lejuar me një rezolute speciale të Mbledhjes së Pergjithshme.

9.13 Dyzetetete orë (48) para Mbledhjes së Pergjithshme të Aksionereve në një vend të dukshëm varet një listë e atyre që kanë të drejtë vote në Mbledhjen e Pergjithshme të Aksionereve. Kjo listë duhet të jetë bërë legalisht, të përmbajë informacionin për Mbledhjen e Aksionereve, perfaqesuesit e tyre dhe numrin e aksioneve. Çfarëdo objeksioni për këtë listë mund të ngrihet përpara se të fillojë sipas rendit të ditës Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve.

9.14 Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve është në sesion të vlefshëm dhe me numrin e duhur të anëtarëve për të filluar me subjektet e rendit të ditës kur se paku 50 % e kapitalit aksioner të paguar është prezent. Nëse kjo kuote nuk arrihet në sesion atëherë thirret një Mbledhje e Pergjithshme e Aksionereve e perseritur, e cila është kurdoherë në sesion të vlefshëm dhe me numrin e duhur të subjekteve të rendit të ditës së fillimit.

9.15 Rezolutat e mbledhjes së Pergjithshme të Aksionereve janë të vlefshme kur marrin shumicën absolute të votave prezente në Mbledhje.

9.16.1 Perjashtimisht, kur rezolutat kanë të bëjnë me :

- a) Shtyrjen e kohezgjatjes së bankes, shkrirjen ose shperberjen e saj
- b) ndryshimin e kombesise së Bankes ose të vendndodhjes së qendres së bankes
- c) ndryshimin e objekteve të diapazonit të biznesit të bankes
- d) shtimin ose pakesimin e kapitalit themeltar
- e) emetimin e obligacioneve
- f) rritjen e detyrimeve të aksionereve
- g) ndonjë ndryshim tjetër të rregulloreve të Bankes



Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve eshte ne sesion te vlefshem dhe ne numrin e duhur per subjektet e rendit te dites kur se paku dy te tretat (2/3) e kapitalit aksioner te paguar perfaqesohet ne mbledhje. Pervec kesaj, Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve mund te zgjidhe me numer te duhur te anetareve dhe me shumicen e (2/3) te kapitalit aksioner te paguar emetimin e obligacioneve me opsion qe te konvertoje obligacionet ne aksione dhe me percaktimin ne te njejten kohe te kohes dhe menyres se ushtrimit te kesaj te drejte. Aksionet qe do te emetohen nga ky konvertim nuk mund te kene nje vlere nominale me te larte se vlera e emetimit te obligacioneve te konvertueshme dhe as mund te kalojne ne total vleren 50 % te kapitalit aksioner te paguar. Me shperndarjen e aksioneve te aksioneret konsiderohet se ka hyre ne veprim nje rritje e kapitalit aksion te nje shume te barabarte.

9.16.2 Neqoftese nuk arrihet numuri i duhur i anetareve ne sesionin e pare therritet nje mbledhje perseritese e pare e cila eshte ne sesion te vlefshem dhe me numrin e duhur te anetareve me subjekte te rendit te dites fillestar kur se paku 35 % e kapitalit aksioner te paguar eshte prezent.

9.16.3 Neqoftese nuk arrihet numri i anetareve te paragrafit te mesiper, ne mbledhjen e pare perseritese te pergjithshme te aksionereve, atehere therritet nje e re e cila eshte e vlefshme dhe me numrin e duhur te anetareve per subjektin e rendit te dites.

Neqoftese eshte rene dakort nga te gjithe aksioneret qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te paguar, Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve, mund te mbahet, dhe vendimet do te jene te vlefshme, pa u marre parasysh formalitetet e siperpermendura per thirrjen e mbledhjes.

9.16.4 Vendimet qe i referohen ceshtjeve te nenit 9.15 merren me shumicen e dy te tretave (2/3) te votave te perfaqesuara ne Mbledhjen e Pergjithshme te Aksionereve.

9.17 Ne Mbledhjen e Pergjithshme te Aksionereve, Presidenti i Bordit te Drejtoreve kryeson perkohesisht, ose nese ai nuk eshte prezent, kryeson Presidenti - Ekzekutiv i Bordit ose anetari prezent me i larte i Bordit (I vjeter, i rendesishem). Presidenti emeron dy sekretare te perkohshem nga aksioneret.

9.18 Kur lista e aksionereve qe kane te drejte vote ne Mbledhjen e Pergjithshme te Aksionereve quhet perfundimtare, atehere mbledhja zgjedh nje Kryetar dhe dy sekretare te cilet gjithashtu marrin persiper detyren e mbledhjes se votave.



Diskutimet dhe rezolutat e Mbledhjes se Pergjithshme te Aksionereve, te përgjithshme apo te jashtezakonshme, kufizohen ne subjektet qe jane regjistruar ne rendin e dites. Per diskutimet e bera dhe rezolutat e marra ne Mbledhjen e Pergjithshme te Aksionereve, mbahet procesverbali qe nenshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari. Kopjet dhe ekstraktet e procesverbalit behen te vlefshme nga Kryetari ose zevendesi i tij.

X. BORDI I DREJTOREVE TE BANKES

- 10.1 Bordi i Drejtoreve te Bankes i perbere prej 3 deri 9 anetaresh zgjidhet nga Mbledhja e Pergjithshme per nje afat kohor prej 3 vjetesh. Bordi i Drejtoreve varet nga Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve. Bordi i Drejtoreve ekzaminon punet e Bankes qe kerkojne shqyrtim dhe vendim kolektiv, te gjitha ceshtjet deleguar atij me rezolucione specifike te Mbledhjes dhe punet e Bankes per te cilat nuk eshte dhene akoma nje rregullore specifike menazhimi. Ai gjithashtu siguron nje zbatim te pergjithshem te rregullt dhe eficient te vendimeve te Mbledhjes se Pergjithshme te Aksionereve per operacionet e bankes.
- Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve vendos per kombesine e Presidentit si dhe te anetareve te Bordit te Drejtoreve.
- 10.2 Punet e Bankes menazhohen lidhur me konceptet e delegimit individual te autoritetit dhe pergjegjesise, politikave dhe procedurave te shkruara dhe nje funksioni kontrolli te brendshem te forte.
- 10.3 Presidenti dhe Presidenti Ekzekutiv i Bordit te Drejtoreve zgjidhen nga Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve. Presidenti dhe Presidenti Ekzekutiv jane kompetente per te ekzekutuar veprimtarite ne emer te bankes secili prej tyre dhe eshte gjithmone Drejtor i Pergjithshem Menazhimi. Kryetari i Bordit te Drejtoreve eshte kompetent te ekzekutoje veprimtarite ne emer te Bankes me firmen e tij te vetme. Presidenti Ekzekutiv do te jete perhere rezident ne Shqiperi dhe do te jete Drejtor i Pergjithshem.
- 10.4 Ne çdo rast te vendeve bosh ne Bordin e Drejtoreve mund te emerohen anetare te perkohshem.



XI. KONTABILITETI DHE DOKUMENTACIONI I BANKES

11.1 Rezultatet e veprimtarise se Bankes reflektohen ne deklaratat financiare mujore, tremujore dhe vjetore, dmth ne bilancet, llogarine e fitimit e humbjeve dhe gjithashtu ne raportin vjetor, te cilat paraqiten ne Banken Kombetare te Shqiperise. Banka boton Bilancin, llogarine e fitimit e humbjeve sipas standarteve dhe kushteve te kushtezuara nga Banka Kombetare e Shqiperise pas vertetimit te autenticitetit te informacionit te paraqitur nga organizatat revizionuese. Viti fiskal ka nje zgjatje prej 12 muajsh duke filluar nga nje (1) Janari dhe duke perfunduar me tridhjetenje (31) Dhjetor te cdo viti. Deklaratat financiare gjithashtu paraqiten ne menyre te pajtueshme me Standartet Nderkombetare te Kontabilitetit.

XII. REVIZIONI DHE KONTROLLI I VEPRIMTARIVE TE BANKES

12.1 Revizionimet e rregullta dhe te jashtezakonshme te operacioneve, kondicioni financiar dhe Bordi i Drejtoreve te Bankes drejtohet nga nje Komitet Revizionimi prej tre anetaresh te zgjedhur nga Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve per nje periudhe tre vjecare. Anetaret e Bordit te Drejtoreve te Bankes si dhe zyrtaret e tjere te Bankes nuk mund te zgjidhen ne Komitetin Revizionues.

12.2 Komiteti Revizionues zbaton dhe kryen me iniciativen e vet nje program revizionimi te plote te operacioneve, menazhimit, kushteve financiare, respektimin e ligjit sic mund te kerkohet nga Mbledhja e Pergjithshme e Aksionereve ose Keshilli. Ai gjithashtu drejton revizionime speciale dhe te pergjithshme neqoftese dhe si te jete kerkuar, nga aksionere qe perfaqesojne 10 % te aksioneve te Bankes, ne nje sesion te Mbledhjes se Pergjithshme. Anetaret e Komitetit Revizionues kane te drejte te revizionojne dhe ekzaminojne te gjithe kontabilitetin dhe dokumentat e transaksioneve dhe raportet revizionuese te brendshme te bankes dhe te marrin shpjegime personale nga Drejtoret, zyrtaret dhe stafi i Bankes.

12.3 Komiteti revizionues i paraqet raportet e tij te revizionimit ne Mbledhjen e Pergjithshme te Aksionereve dhe ne Banken Kombetare te Shqiperise permes Bordit te Drejtoreve qe mund te komentoje mbi keto raporte. Komiteti revizionues zbaton konkluzionet mbi raportet dhe bilancet vjetore. Mbledhja e Pergjithshme e zakonshme vjetore e Aksionereve do te miratoje ligjerisht

deklaratat financiare vjetore te Bankes vetem pas nje certifikate te komitetit revizionues mbi deklaratat financiare vjetore dhe raportit te Bordit te Drejtoreve.

12.4 Anetaret e Komitetit Revizionues mund te marrin pjese ne mbledhjet e Bordit te Drejtoreve, nese kerkohet, me te drejte vote konsultative. Ne rast se nga revizionimi dokumentohet nje kercenim i dukshem dhe i padiskutueshem mbi interesat reale te Bankes, perfshire rastet e abuzimeve serioze ne detyre te nepunesve te Bankes, komiteti revizionues ka force ti kerkoje Bordit thirrjen e nje Mbledhje te Pergjithshme te Jashtezakonshme te Aksionereve. Diskutimi i kesaj ceshtje ne Bordin e Drejtoreve duhet gjithnje te dokumentohet ne menyre analitike ne protokoll.

12.5 Revizionimi dhe kontrolli i veprimtarive te Bankes gjithashtu ekzekutohet nga Banka Kombetare e Shqiperise dhe gjithashtu edhe nga organet e tjera ne perputhje me Ligjet Shqiptare.

12.6 Komiteti revizionues paraqet gjithashtu raportet e tij revizionuese ne menyre te pajtueshme me Standartet Revizionuese Nderkombetare.

XIII. LIKUJDIMI I VEPRIMTARIVE TE BANKES

13.1 Banka shperbehet ne perputhje me Ligjin per shoqerite aksionere dhe gjithashtu ne rastet qe kushtezohen nga Ligjet Shqiptare "Mbi Banken dhe Sistemin Bankar" dhe "Mbi Banken e Shqiperise".

Ne likujdimin e Bankes pjesmarresit (aksioneret) formojne Komitetin likujdues me pjesmarrjen e perfaqesuesve te Bankes Kombetare te Shqiperise, ne

perputhje me vendimet e organit suprem te drejtimit te Bankes.

Ne rast se Banka shperbehet mbi bazen e pezullimit te licenses per operacione bankare, likujdimi i Bankes ekzekutohet nga Komiteti Likujdues, emeruar nga Banka Kombetare e Shqiperise. Qe nga momenti i emerimit te komitetit likujdues, ai ka fuqi te drejtoje punet e bankes. Ne likujdimin e Bankes fondet monetare perfshire te ardhuren e perfituar nga shitja e pasurise se Bankes, pas pagimit te buxhetit, me gjithje shperblimin monetar paguar stafit dhe plotesimit te detyrimeve ndaj pronareve te obligacioneve te emetuara nga Banka, dhe ndaj



akcionerëve të tjerë, shpërndahet atëherë mes Akcionerëve në proporcion me
vlerën e aksioneve që u takojnë atyre (ose në një rend të ri nëse kështu
parashikohet nga këto rregullore).

13.2 Shpallja e likuidimit të veprimtarive të Bankës botohet në shtyp.

Athine më 4 Shtator 1995

(firma)

ZEVENDES DREJTOR I PERGJITHSHEM
KRYETAR I GRUPIT BANKAR NDERKOMBETAR
TE " BANKES TREGTARE TE GREQISE S.A. "

Perktheu
EDUARD SULO